

## PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 26 MARS 2026

Kryesuesi I mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 27

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 27

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo dhe Drejtorë të Administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 2

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mirëdita të gjithëve fillojmë mbledhjen e rradhës, materialet janë shpërndarë, në tavolinë kemi edhe një material shtesë e cila erdhi pasi u mblodh kryesia, ndaj ftoj këshilltarët të miratojnë edhe futjen e këtij materiali në rendin e ditës e cila ka të bëjë me rialokimin e fondit prej 801 mijë e 777 lekë për mirëmbajtje në fushën e sportit të vogël.

Këshilltar E.Bregu: Meqënëse u fut një material në rendin e ditës, ne vazhdimisht kemi pasur në diskutim dhe kemi kërkuar që në rendin e ditës, për futjen e disa çështjeve të tjera, siç është ngritja e komisionit për verifikimin e banesave sociale, një kërkesë e cila është ngritur vazhdimisht nga një qytetare dhe Këshilli ka rënë dakort ta ngrëjë. Ka ngritur një komision i cili do merret me hartimin e rregullores dhe ligjeve, i cili besoj se është jashtë kompetencave por gjithsesi është anashkaluar kërkesa bazë për të cilën është vendosur dhe duhet të futet në rendin e ditës edhe kjo çështje për ngritjen e komisionit. Ngirtja e komisionit të përkohshëm lidhur me auditin 2022 dhe kjo kërkesë e firmosur nga 11 këshilltarë është mbajtur prej vitesh në kryesinë e Këshillit apo kryetares të Këshillit gje që është e jashtëligjshme, shkelje e rendë institucionale dhe duhet të vijë sa më parë në Këshill për vendim ndoshta të miratohet, ndoshta të rregullohet por nuk mund të mbahet pezull. Kemi kërkuar disa informacione siç është për ekipin e futbollit “Skënderbeu”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem informacionet, janë informacione, po flas për pikat e rendit të ditës që kërkojnë votim.

Këshilltar E.Bregu: Ato janë pika që duhen futur në rendin e ditës.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Në lidhje me shqetësimin e parë që ju kishit po ja jap fjalën Edës për të dhënë informacion të plotë, sepse ju e dini që ky komision është ngritur për hartimin e rregullores.

Këshilltare E.Mitre: Faleminderit znj.kryetare, komisioni ka përfunduar punën e tij, kemi përfaqësues Lazjonin dhe Kristiano Koçibellin bashkë me Drejtorinë e Strehimit, kemi përfunduar rregulloren dhe kemi rënë dakort për miratimin e kësaj rregullore, ajo do kalojë për

konsultim publik me njerzit e kësaj kategorie dhe pastaj do sillen në Këshill, mbase muajin tjetër, sepse do 21 ditë pune për konsultimin publik, mos gaboj.

Këshilltar E.Bregu: Unë po flas për komisionin e verifikimit, jo të hartimit të rregulloreve.

Këshilltare E.Mitre: Verifikimin e bën drejtoria.

Këshilltar E.Bregu: Ra dakort që ngrihet një komision për verifikimin.

Këshilltare E.Mitre: Ne si komision jemi njohur me të gjitha.

Këshilltar E.Bregu: Keni ngritur një komision tjetër lloj për të thënë se keni ngritur një komision, ky është problem.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse ju e shikoni kështu, është mendimi juaj ne nuk e kemi parë me këtë formë. E dyta drejtoria ka nxjerrë gjitha ato që duhen, kush banon, kush jo, duhet të merrni pjesë tek konsultimi publik sepse duhet mendimi i të gjithëve.

Këshilltar E.Bregu: Ne kemi kërkuar të marrim pjesë tek komisioni i verifikimit, ratë dakort që do ngrihet një komision për verifikim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ky komision duhet të funksionojnë mbi bazën e një rregulloreje.

Këshilltar E.Bregu: Ka rregullore Këshilli.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Duhet rregullore specifike. Kush është dakort me rendin e ditës?

### **Pika 1 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E NJË PIKE SHITESË NË RENDIN E DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 5

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 21 pro, 5 kundër, 1 abstenim.

### **Pika 2 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kush është dakort me rendin e ditës në tërësi?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

### **Pika 3 e rendit të ditës.**

“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS DATËS 26 SHKURT DHE 13 MARS 2026”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka diçka nga këshilltarët?

Këshilltar D.Osmani: Kisha një pyetje lidhur me procesverbalin meqënëse ne kemi kaluar në votim elektronik, procesverbali kur na vjen na vjen në votim në përgjithësi, kush ka votuar pro, jo me emrat e gjithsecilit nga ne. Duke qënë se ky votim nuk është i fshehtë, këtu nuk ka ndonjë tabelë sesi votojnë këshilltarët. Do doja bashkë me procesverbalin të na vinte dhe lista kush ka votuar, e para për të qënë transparent dhe e dyta për të kuptuar më mirë votimin që ndodh.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka diçka nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

### **Pika 4 e rendit të ditës.**

“PËR MIRATIMIN E DORËHEQJES TË KËSHILLTARIT Z.ERJON NEXHIPI”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni i mandateve ju lutem.

Këshilltar E.Muharrem: Përshëndetje të nderuar kolegë, pranë Këshillit Bashkiak është depozituar një kërkesë, kjo kërkesë është depozituar si për ligjin e vetëqeverisjes vendore ashtu edhe mbi rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak. Arsyet këshilltari i ka shprehur tek kërkesa, ftoj kolegët ta votojnë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka diçka nga këshilltarët?

Këshilltar L.Petri: Zonja kryetare mos vallë është e udhës të shoqërohet dorëheqja e kolegut tonë, me propozimin e atij që do zerë vendin?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nuk e vendosim ne, vendos KQZ-ja, kush është këshilltari i rradhës. Z.Bregu kishe diçka?

Këshilltar E.Bregu: Këshilltari ka disa kohë mungon në mbledhjet e Këshillit, sa kohë ka që nuk merr pjesë?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kjo është mbledhja e gjashtë që nuk merr pjesë. Nëse nuk ka diçka tjetër, hap procesin e votimit?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 25 pro, 1 kundër, 1 abstenim.

### **Pika 5 e rendit të ditës.**

“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1- 28 SHKURT 2026”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare E.Mitre: Për muajin shkurt janë 49 familje përfituese nga program i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % e fondit të kushtëzuar, 49 familje përtojnë nga sistemi i pikëzimit në shumën 167 mijë e 117 lekë. Gjithashtu kemi 7 familje përfituese të energjisë elektrike me shumën 6 mijë e 424 lekë dhe nga fondi i buxhetit vendor 11 familje me shumën 50 mijë e 591 lekë. Kemi 5 familje që dalin nga skema, 9 familje që rifuten dhe 3 familje që futen për herë të parë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje?

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me ndihmën ekonomike, të gjitha Bashkitë në Shqipëri, të gjitha shtresat në nevojë nga Bashkimi Europian po alokohen rreth 65 milion euro në vit, në ndihmë të Shqipërisë. Duke pasur parasysh që ndihma që ju jepet është shumë e ulët mos ndoshta Bashkia duhet ta shohë të udhës që t'i bëjë presion Qeverisë që këto fonde të përdoren me efikasitet në favor të familjeve që janë në nevojë?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Më vjen mirë që e keni këtë shqetësim sikurse dhe ne dhe e kemi dhe do donim që ndihma ekonomike të ishte më e lartë. Ju keni bërë të njëjtën pyetje edhe mbledhjet e kaluara dhe nga Drejtoria përkatëse ju është dhënë përgjigjia e duhur. E vetmja gjë që mund të bëjmë është ta përcjellim si shqetësim tek drejtoria përkatëse, nuk vendosim ne sesa do jetë masa.

Këshilltar E.Bregu: E kisha për Kryetarin e Bashkisë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Si kryetari i Bashkisë, si ekzekutivi njësoj.

Këshilltar E.Bregu: A e dini që merren 65 milion euro në vit nga Bashkimi European?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo nuk jam në dijeni të faktit, nuk e di si është kompozuar buxheti që shpërndahet nga ana e Qeverisë. Roli i Bashkisë është hartimi i listave sipas sistemit të pikëzimit, miratimi i tyre në Këshill dhe çuarja e këtyre listave në institucionet financiare.

Këshilltar E.Bregu: Ky është një fakt që të jep ty mundësinë t'i bësh presion Qeverisë meqenëse na premtove herën e kaluar, ke një mundësi t'i bësh presion për diçka që është me vlerë në ndihmë të banorëve që t'i përfaqëson që janë banorët në nevojë për kontributin tend.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit z.Bregu, nëse nuk ka diçka tjetër po hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

#### **Pika 6 e rendit të ditës.**

**“ PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 NË NIVEL PROGRAMI.”**

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Komisioni ka dërguar për miratim relacionin për miratimin e tavaneve. Ky kufij i sipërm shpenzimesh jepet për të garantuar planifikimin në përputhje me të ardhurat. Këto tavane janë hartuar për 11 programe që përfshijnë 27 funksione. Burimet e financimit janë të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore, të cilat janë parashikuar me një rritje 1 % nga viti në vit, transferta e pakushtëzuar në rritje 2 % për vitet 2027-2028 dhe 1 % në vitin 2029. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme e cila është parashikuar në rritje 5.8 % në vitin 2026, 5.4 % në vitin 2027, 5.6 % në vitin 2028 dhe 5.4 % në vitin 2029, si dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale. Shpenzimet e parashikuara për këtë periudhë janë shpenzimet e personelit parashikuar në rritje 3 % për vitet 2026-2027 dhe 1% për vitet 2028-2029, shpenzimet korente 1 % nga viti në vit si dhe shpenzime kapitale që janë parashikuar në rritje 11 % në vitet 2026-2027, 8 % në vitin 2028 dhe 9 % në vitin 2029. Ju ftoj ta miratoni.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje apo diskutime nga këshilltarët?

Këshilltar D.Osmani: Shpenzimet e personelit kanë një rritje prej 3 % nga viti 2027 në 2026 dhe rritje 1 % të viteve të tjera. Pyetja ime është pa ç'ka se Bashkia Korçë vazhdon të ketë një rritje të pagave për personelin, ne akoma vazhdojmë që vitet në vazhdim të kemi përsëri rritje të pagave të personelit dhe të vazhdojmë të rritim pagat e Bashkisë në një kohë ku popullsia po tkuret. E dyta

thuhet se shpenzimet koerente kanë një rritje 1 % në vit. Tani nëse unë shikoj këtu planin e ndryshuar 2026 dhe planin e 2027 në vazhdim, plani i 2026 është 992 milion, i 2027 969 milion, plani i 2027 me 2026 është më i vogël, e njëjta gjë është edhe përsa i përket shpenzimeve kapitale ipas drejtorisë thotë që kemi një rritje prej 11 %, nga 539 milion që janë shpenzimet kapitale plani i 2027 është 342 milion dhe kjo nuk është rritje është ulje. Për këto doja disa sqarime. Në kalendarin që kemi miratuar ne është 15 marsi afati i fundit që duhejsjellë në Këshill dhe duhej miratuar. Tani pse i anashkaluat afatet?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Para se t'i jap fjalën kryetarit, po i jap fjalën Drejtoreshës të Financës.

Drejtorja e Financës V.Ziko: Po e nisa nga kjo e fundit, pastaj vazhdoj me sqarimet e tjera. Është e vërtetë që ishte deri në datën 15 mars por udhëzimi për hartimin programin buxhetor afatmesëm për të ndryshuar të gjitha fazat është nr.7 i datës 27.02 dhe transfertat në system pasi të gjitha hidhen në sistemin e menaxhimit të buxhetit vendor janë hedhur në muajin shkurt, kështu që është e pamundur. Ndërkohë që afati për dorëzimin e dokumentave është 10 ditë para nuk mund të respektohet data 15 mars dhe çdo vit e kemi futur në mbledhjen e fundit të datës që zhvillohet në muajin mars dhe kjo nuk përbën ndonjë problem e kemi diskutuar edhe me Ministrinë e Financave. Në lidhje me shpenzimet e personelit dhe të gjitha shpenzimet e tjera, kur parashikohen tavanet i referohemi buxhetit fillestar dhe kjo nuk është hera e parë. Ndërsa buxheti i ndryshuar përfshin edhe të ardhurat e trashëguara, parandaj është ky disnivel ku në të ardhurat e trashëguara janë parashikuar edhe të vitit 2025 që janë realizuara dhe janë parashikuar edhe të ardhurat e 2026, nuk mund të bëhet vlerësimi me buxhetin e ndryshuar sepse përfshihen edhe të ardhurat e trashëguara. Nëse i referohemi buxhetit të vitit 2026 në thesari, shpenzimet për paga janë rritur 3 %, për arsye sepse në përdorimin e të ardhurave të trashëguara, është parashikuar edhe rritja e pagave si rezultat i indeksimit deri në 2.5 % që është marrë parasysh edhe në buxhetin e vitit 2027, nuk ka rritje, as ndryshim të stafit është thjesht efekti financiar që vjen si rezultat e indeksimit të pagave dhe njëkohësisht ndryshimi i vjetërsisë sepse vjetërsia tani llogaritet mbi shtesën e funksionit dhe jo mbi diplomën. E njëjta situatë është dhe për shpenzimet e personelit, ndërsa shpenimet për investime janë me rritje deri në 11 % për vitin 2027, 8 % për vitin 2028 dhe 9 % për vitin 2029, duke ju referuar buxhetit fillestar 2026.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, fjala për kryetarin, ndoshta fjala e kryetarit i zë boshlleqet tuaja.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Do them vetëm diçka në lidhje me atë pjesën e shpenzimeve të personelit dhe pjesa e pagave. E kemi bërë këtë diskutim edhe mbledhjen e kaluar. Shpenzimet e personelit përcaktohen nga dy gjëra, e para është numri i punojësve dhe e dyta niveli i pagave dhe dua t'ju siguroj që asnjëra nga këto komponentë nuk ka asnjë abuzim nga ana e Bashkisë. Në lidhje me numrin e punojësve të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë mund ta shikoni edhe në materialet që sjellim për miratim nuk i punojësve të planifikuar është më i madh se numri faktik që ne kemi në Bashki, nuk ka ndonjë tendencë në Bashki të marrë njerëz në punë pa u dashur. Ne jemi munduar të operojmë me stafe minimale. Në raste të caktuara me kuadër ligjor duhet të kemi më shumë staf. Përshembull kemi dy raste, sektori i dy i emergjencave deri tani kemi dy punojës dhe një drejtor, ndërkohë që duhet ta kishim në nivel drejtorie dhe të kishim minimum 7 punojës sipas ligjit të emergjencave. E njëjta gjë vlen edhe për sektorin e emigracionit, aktualisht e kemi

sector me 2 punjës ku në bazë të ligjit duhet ta kshihim drejtori. Nësene do donim të shtonim do kishim 14 veta dhe nuk mund të na thoshte dot asnjë person asgjë sepse jemi me ligj dhe në vend të 14 veta kemi 3. Në lidhje me numrin po përpiqemi të funksionojmë me struktura minimale por atje ku duhet do marrim që të bëhet puna. Në lidhje me pagat, ke këtë strukturë si e paguan?

Ja u kam thënë edhe mbledhjet e kaluara, nuk është se Bashkia ka tagrin të caktojë pagat siç do ajo, ka një kuadër ligjor i miratuar me vkm i cili cakton nivelin e pagave të pushtetit vendor në bazë të madhësisë të Bashkisë dhe pagat të cilat marrin punojësit tanë janë brenda këtij niveli të miratuar me vkm. Këto janë dy komponentët që përcaktojnë nivelin e pagave.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, z.Osmani kishit përsëri pyetje, apo plotësim?

Këshilltar D.Osmani: Tani ky debati i pagave për punojësit e Bashkisë mendoj se është mision i pamundur për të na bindur ne që ka shumë të drejtë dhe punojësit e Bashkisë janë 7-8 orë në dispozicion të qytetarëve. E para njëherë 49 % e shpenzimeve të Bashkisë Korçë po flas për 2026 dhe planifikimi që keni bërë për vitet në vazhdim shkon vetëm për shpenzime personeli sipas shifrave tuaj, gjysma e shpenzimeve që Bashkia kryen shkon përpersonelin. Nëse ne këtë e kemi kthyer në shërbim ndaj komunitetit, unë do isha i pari që nuk do flisja sepse duhet bërë por të paguash gjysmën e shpenzimeve për të mbajtur njerëz në punë, ndërkohë që ne e dimë se sa punojës vijnë vërdallë kot për tu marr me veten e tyre jo duke u shërbyer komunitetit po doni ju japim edhe emra. E dyta Bashkia në vitin 2015 ka patur mesatarisht 300 punojës dhe komuna më e madhe në atë kohë, ajo e Bulgarecit ka pasur 18 punojës. Po të marrësh një mesatë punojës të Bashkisë kanë qënë + ose – 500, sot ke 1342, nëse ju më bindni.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Vetëm Bashkia.

Këshilltar D.Osmani: Nuk e kam këtë shifër por e di që ke 1342, 500 po them unë kanë qënë si Bashkia me gjithë komunat. Tani sot ke 1300 punojë në këtë Bashki.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal që po të ndërpres por krahaso gjëra të ngjashme, mos krahaso numrin e punojësve në Bashki në 2015 me numrin e punojësve sot bashkë me ndërmarjet në varësi.

Këshilltar D.Osmani: Nuk po i shtoj kot.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pse çfarë janë këto fasule?

Këshilltar D.Osmani: Janë punojësit e Bashkisë jo fasule, nuk është nevoja t'i ofendojmë punojësit. Të shkojë 1300 numri dhe jut ë vazhdoni të thoni se nuk i kemi plotësuar sipas ligjir nuk mendoj se është në rregull.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Punojës faktik janë më pak, janë 1983, institucion, ndërmarrje të ndryshme.

Këshilltar D.Osmani: Dhe të vazhdojmë të planifikojmë rritje, nuk më duket normale. Mendimi im gjëja e parë që ju duhet të bëni si drejtues institucioni është rishikimi i numrit të punojësve, nuk dua ta përsëris prapë përderisa ne kemi rënie të popullsisë, nuk kemi pse të planifikojmë rritjen e punojësve duke rritur shpenzimet e personelit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Krahasimi ishte i gabuar, u tentua të krahasohej numri i punojësve si Bashki në 2015 dhe numri i punojësve të Bashkisë bashkë me institucionet e varësisë. Tani shifrat ja japim, nuk mendojmë se 100 % e stafit të Bashkisë është në efikasitet maksimale. Në rast se keni informacion për punojës që nuk vijnë në punë qoftë publikisht, qoftë në veçanti mund të ma thoni, sepse unë si kryetar Bashkie nuk toleroj dhe nuk inkurajoj asnjë që nuk vjen në punë. Efikasiteti pastaj nuk mund të kontrollohet vetëm nga kryetari i Bashkisë por çdo përgjegjës duhet të kontrollojë punojësit e drejtorisë të tij, të arrijë në efikasitetin maksimal. Po të ishte që të tentoja të bëja ndere me pozicionet e punës në Bashkia e kisha mundësinë t'i bëja, ta përmenda dhe ligjin t'i përmenda dhe drejtoritë që kam 3 punojës. Ju kam kërkuar dhe punojësve të institucioneve të varësisë të jenë shumë kërkuar dhe punojësit i kemi marrë sezonale. Niveli i pagave është përcaktuar me vkm, shkon në 49 % të buxhetit. Shumica e punëve nuk ka lidhje me numrin e banorëve, po marr shembull ndriçimin edhe sikur të jenë 200 banorë edhe sikur do jenë 10 shërbimin e ndriçimit do e ofrojmë. Më thuaj ti një komponent.

Këshilltar D.Osmari: Unë e pres nga ty.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë të mora dy shembuj, nuk ka korelacion numri i popullsisë me nivelin e shërbimit. Më thuaj ti disa që kanë.

Këshilltar D.Osmari: Pastrimi i qytetit, sa më pak njerëz aq më pak pis.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është e vërtetë sasia e mbetjeve që gjenerohen është e lidhur me popullsinë. Në një rrugë që janë dy kosha si të jenë gjithë banorët të mbushin koshin plot, si ta mbushin treçerek të koshit makina do shkojë për ta marrë dhe po të them edhe njëherë se pjesa më e madhe e shërbimeve nuk kanë korelacion me numrin e popullsisë duhet t'i bësh me të njëjtin nivel, lidhen me territorin nuk lidhen me numrin e popullsisë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kush e do fjalën për diskutim, pa përsëritur të njëjtat gjëra dhe pa bërë pyetje- përgjigje?

Të lutem se u bë si pyetje-përgjigje, t'ja jap fjalën znj.Qeleshi.

Këshilltar D.Osmari: Nuk po e bën njeri pyetje-përgjigje ne duam sqarime, nuk po e bëj politike.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Politike po e bëni.

Këshilltar D.Osmari: Nuk është politike të pyesësh kryetarin e bashkisë për punojësit e Bashkisë, e dyta mund ta bëni dhe ju prandaj jeni kryetare Këshilli.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem mos ma citoni për çfarë jam.

Këshilltar D.Osmari: Nuk ke pse e merr si ofendim sepse ne po diskutojmë diçka dhe kryetari nuk ka pse e merr si ofendim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Unë thashë mos bihem në përsërtije.

Këshilltar D.Osmari: Ne do e marrim dhe fjalën.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Patjetër sipas rregullores. Z.Qeleshi.

Këshilltare M.Qeleshi: Një sqarim të vogël për fjalën e kryetarit, vërtet kryetar që fondi i pagave varet nga numri i punojësve dhe pagat që janë me vkm, po nuk ka të bëjë me faktin që ju thoni kaq dhe aq, planifikimi në tavanet është bërë me numrin 1342 punojës, nuk bëhet për realizimin, ne realizimin e bëjmë në një fazë tjetër dhe janë dy faza të ndryshme, planifikimi dhe realizimi. Kështu që të thuash që kemi kaq dhe ta quash si diçka pozitive, kur bëhen tavanet, bëhen për numrin e planifikuar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër që planifikimi dhe realizimi janë dy faza të ndryshme dhe tavanet buxhetore lidhen me planifikimin dhe si logjikë financiare tavanit shkon duke u rritur nga viti në vit, sipas një trendi që është i përcaktuar në një lloj mënyrë. U ndala tek fakti sepse fakti është shumë i rëndësishëm. Planifikimet janë një gjë ama ne mundohemi gjatë vitit ne përpiqemi që t'i mbajmë në kontroll dhe ajo që ka më shumë rëndësi për mua është që buxhetin faktik ta mbajmë të balancuar, në varësi të të ardhurave shohim edhe ecurinë e investimeve dhe shpenzimeve, kur shohim që kemi problem të balancuar e shtrengojmë ca. Deri më sot nuk ka ndodhur që të kemi detyrime të prapambetura dhe të na trokasë dikush në derë.

Këshilltar I.Bode: Kryetar unë ja u kam thenë edhe kur kemi diskutuar për buxhetin ju nuk keni një analizë të detajuar të efijencës të administratës që ju drejtoni. Po të dalim në qytet kemi parë edhe 4 veta 1 lopatë që rrinë në lulishte po mos i hyjmë kësaj pune. Problemi nuk qëndron që ju harxhoni pjesën më të madhe për rroga por ju harxhoni edhe pjesën më të madhe për shpenzimet operative dhe për investime ju mbeten thërrime dhe nuk po ecim para, ok ju e mbani buxhetin e balancuar. Edhe diçka tjetër ju thoni që ligji më lejon të kem 7 punojës për emergjencat dhe unë mbaj dy, nuk e kuptoj as këtë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe njëherë për kompozimin e buxhetit të Bashkisë janë 3 grupe. Grupi për pagat dhe sigurimet shoqërore që e sqarova gjatë e gjërë nuk ja vlen të bëjmë diskutim politik dhe të mbushim mendjen e njëri-tjetrit. Përsa i takon shpenzimeve operative vërtet grupi e ka emrin shpenzime operative por Brenda këtij grupi janë një pjesë e grupeve që ofron Bashkia, sepse Bashkia nuk është kompani investimesh, Bashkia ofron shërbimin e pastrimit, ndriçimit, aktivitetet kulturore, sportive, kalendari i eventeve. Kemi dhe blerje materiale e cila nuk klasifikohen investime sepse bëhen nga ana e Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike por në fakt janë investime sepse ne blejmë materiale, pllaka, zhavore. Transportin publik për pensionistët që është falas e kemi përsëri tek ky grup, këto janë të rëndësishme, qendrat e fëmijëve dhe pleqve. Varet me kë i krahasoni në kë periudhë të qeverisjes demokratike në nivel lokal, doni t'i krahasoni, sit ë doni ju e bëjmë krahasimin por më besoni nuk ju leverdis ju ta bëni këtë krahasim. Janë bërë investime shumë të madhe, sidomos në periudhën që

Këshilltar D.Osmani: ( Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani unë nuk të ndërpreva, e shikon që kur e paraprin kësaj që do dalësh keq me krahasimet fillon bën zhurmë. Do ta bëjmë krahasimin?

Këshilltar E.Bregu: ( Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: T'i ze me rradhë të gjitha zonat publike në qytet, sheshi para Katedrales, zona këmbësore, sheshi para Teatrit, restaurimi i Pazarit të Vjetër të Korçës, ndërtimi i Muzeut të " Gjon Millit", ndërtimi i Qytetzës të Fëmijëve, ndërtimi i zonës sportive

rikonstrukcioni i Voskopojës i cili është një fshat i madh. Poli i dijes, ndërtimi i infsastrukturës për Liceun Francez. Përmenda vetëm projektet e mëdha, shpresoj mos kem harruar ndonjë. Ka shumë projekte të mesme, rikonstrukcioni i shkollës “ Sotir Gura”. Do fillojmë një projekt të investimeve në rrugët e fshatit, në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit do bëjmë rikonstrukcionin dhe rivitalizimin e bulevardit “ gjergj Kastrioti”, projekt shumë i madh edhe një grup tjetër projektësh. Aeroporti ka mbaruar siç e kam thënë edhe në premtimet është aeroport turistik dhe sportive, ka mbaruar ndërtimi i godinës, tani do ta kalojmë me pistë asfalti. Këto janë ato Mirela që mu kujtuan me shpejtësi.

Këshilltare M.Qeleshi: Bëre fushatë, gati je për mot.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem znj.Qeleshi sepse po ndërhyjni ndërkohë që z.Bode kishte fjalën.

Këshilltar I.Bode: Komplimente kryetar për kujtesën e admirueshme por po flisnim për investimet që bën Bashkia, j una numëruat një seri investimesh, por ne po flsinim për investimet që bën Bashkia me fondet e saj këtu e kishim fjalën derisa të fillonte politik juaj. A keni 14 % të buxhetit të parashikuar për investime?

Me këto 14 % i bëtë të gjitha këto vepra madhore?

Latë pasdore termoizolimim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Keni diçka tjetër z.Bode?

Nuk do bëjmë pyetje përgjigje, ju lutem përmbliidhni mendimin tuaj, mos dalim të bëjmë politikë sepse kemi e pika të tjera në rendin e ditës për të miratuar.

Këshilltar I.Bode: Përsa kohë diskutohet si do i prishim paratë, pse mos bëjmë politikë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Për këtë pikë jo vetëm që nuk mërzhitem por ju falenderoj që më dhatë mundësinë të listoj edhe për ju edhe për banorët projektet e Bashkisë për këtë vit, pavarisht se kush janë burimet e financimit sepse nuk besoj se njerëzit pyesin nga vijnë financimet. Shumë nga këto projekte janë projekte të mëdha dhe do ishte e pamundur të bëheshim me buxhetin e Bashkisë, shumë financohen nga Qeveria Shqiptare të cilën e falenderoj në emrin tuaj dhe të Bashkisë. Janë projekte shumë të rëndësishme për të ardhmen e qytetit. Ti Mirela e thua kështu si me ironi por njerëzit nuk ecin vetëm e slogane dhe parulla duhet të përpiqesh, të punosh. Edukimi i mirë i fëmijëve nëpërmjet Polit të Dijes dhe Liceut Francez, i shërben jo vetëm mbajtjes të të rinjve dhe të rejave në qytet duke ju ofruar një arsim më cilësor por edhe vizionit apo qëllimit për ta kthyer Korçën në qytet univeristar.

Këshilltar D.Osmani: Pikënisje e këtij diskutimi ishte krahasimi, tani edhe në lidhje me krahasimin, të krahasosh 14 vjet para se çfarë është bërë kur edhe kryetari edhe ne e mbajmë mend që 8 vjet ka qënë qeverisja e Partisë Demokratike 2005-2013, 4 vjet ka qënë nga Partia Demokratike, 4 vjet të tjera ka qënë e udhëhequr nga ju. Nuk e ka fajin Qeveria që Bashkitë nuk kanë projekt, ajo nuk mund të mbështesë nëse ju nuk keni projekte.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: ( Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar D.Osmani: Nuk do hapim petët e lakrorit këtu e 13 para sepse 2013-2026 i thonë 13 vjet. Qeveria ka mbështetur projekte që ju keni pasur, e vetmja pike.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: ( Nuk ka audio, flet pa mikrofon.). Devi më fal, Bulevardi “ Republika”është financuar me buxhet 100% bga Bashkia, zona këmbësore është bashkëfinancim Bashkia me Fondacionin Shqiptaro- Amerikan, kalldrëmet janë bërë në kuadrin e projektit të kanalizimeve të Korçës, unë kam qënë në Bashki e di. Fillimisht projekti ka pasur vetëm projektin e kanalizimeve, projekti i kanalizimeve përfshirë dhe kalldrëmet është financuar me një kredi që KFV ja ka dhënë Ujësjiellës Kanalizimeve, ka qënë Bashkia pronare e Ujësjiellësit, ku ai ka marr kredi nga KFV për të bërë këtë investim. Qeveria ka qënë garant i kredisë, kjo është e vërteta pa fshehur asgjë.

Këshilltar D.Osmani: Për ta mbyllur këtë diskutim se vajti pak gjatë, që ka pasur investime asnjë nga ne nuk e fsheh dhe nuk e mohon as nuk ka pse. Një problem kam që duhet marr me seriozitet pavarisht investimet në qytet e keni menduar ikjen e njerzve, përveç asaj fjalës klishe që ikin kudo dhe ikin edhe këtu tek ne dhe a është menduar që të bëhet diçka me largimin e të rinjve?

Sepse kjo nuk është diçka e mirë as për të majtë as për të djathtë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Largimi i popullsisë është një nga problematikat më të mëdha edhe një nga sfidat kryesore është si ta ngadalësojmë këtë problem Tani po e filloj nga kjo nuk është fjalë klishe që largimi dhe emigrimi ndodh në të gjitha vendet, është një fenomen që i prek të gjithë vendet edhe vendet më të zhvilluara, nuk ndodhin vetëm nga vendet e Ballkanit por ikin edhe nga Greqia, Spanja, Portugalia. Një arsye është arsye ekonomik, ikin drejt vendeve më të zhvilluara. Ka disa iniciativa të rëndësishme të Qeverisë duke ndërhyrë tek paga minimale, tek niveli i pagave të Administratës duke hequr disa faktorë që i shtyn njerëzit për tu larguar.

Këshilltar D.Osmani: ( Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Një nga pasojat e rritjes të pagave në shtet është tendenca për të kaluar nga private në shtet por si e shoh unë?

Unë e shoh si një mekanizëm që synon të nxitë edhe biznesin privat që t’i rritë pagat por edhe kjo duhet bërë me kujdes sepse biznesit mund të dojë t’i rritë pagat po do dale jashtë llogjiksës të tregu. Ajo që mund të bëhet në nivel local, është mbështetja e sektorëve që ne i konsiderojmë prioritarë, ndaj po mbështesim sektroin e buqësisë, pjesa e projekteve të edukimit janë të rëndësishme sepe lidhet drejt për drejt me të rinjtë. Këto janë gjërat që po përpiqemi t’i bëjmë, është sfidë e madhe, në rast se keni ide jemi të hapur e mira është të vijmë me disa propozime. Ne si prioritete kemi pjesën e turizmit, buqësia, edukimi dhe teknologjia që lidhet me edukimin. Të jetojmë në një hapësirë që është e rregulluar dhe ky është një faktor që i mban ose i nxit që të largohen.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit kryetar. Përsëri diskutim lidhur me këtë çështje.

Këshilltar E.Bregu: Faleminderit znj.kryetare. Në lidhje me pikat që tha kryetari, së pari aeroporti, unë kam pak njohuri në fushën e ndërtimit, ndoshta kryetari ka informacion. Nuk e di nëse puna për ndërtimin e aeroportit nis nga ndërtimi i një godine?

Mesa di unë bëhet infrastruktura , pastaj fillohet me të tjera edhe nuk e di ky deklaram që tha kryetari mua më duket gafë e madhe dhe mbase ka nevojë ta korrigjojë. Zbatimi i projektit të aeroportit të Lumalasit ka filluar duke bërë godina. Së dyti meqënëse kryetari ka bërë shumë investime dhe i ka dalë nga mendja, gjatë qeverisje demokratike gjithë rrugët rulare janë asfaltuar, madje ai lideri juaj kur ishte në opozitë që të shante Ikryeministrin thoshte ne pyesim për ujë ai thotë rrugë. Ajo qeverisje ju ka financuar ju dhe ndërtimin e gjitha kalldrëmëve të Korçës. Madje kryetari e mban mend shumë mire sesi dilnit e prisnit kryeministrin Sali Berisha deri në Pogradec që t'ju financonte këto.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E fundit dhe nuk flas më, nuk është turp që një kryetar Bashkie të dalë e të presë Kryeministrin edhe pse nuk i takon të njëjtës force politike dhe të bashkëpunojë me të. Nëse kryetari i Bashkisë i asaj kohe Niko Peleshi ka takuar kryeministrin e asaj kohe Sali Berisha nuk shoh se ka ndonjë gabim. Përsa i takon aeroportit, projekti fillestar aeroporti i Lumalasit të operonte me pistë bari dhe u ndërtua dhe godina dhe ne do operonim me këtë infrastrukturë e cila është e mjaftueshme me aktivitetet që kemi menduar të bëhen këtu. Përfshijmë edhe shërbimet në kuadrin e emergjencave apo avionëve në funksion të buqësisë. Pista do bëhet me asfalt dhe kjo e zgjeron gamën e mundësive të projekteve që mund të zhvillohen. Asfaltimi i rrugëve të fshatrave sepse nuk dua t'i rëndoij kryetarët e komunave të fshatrave të asaj kohe, në rast se do na kishin lënë një infrastrukturë të saktë do ishim duke u marrë me gjëra të tjera, fatkeqësisht infrastruktura e lënë ka qënë si mos më keq, kanë qënë vetëm 3 fshatra Dvorani, Drenova dhe Mborja të cilat kanë qënë gjysëm të investuara edhe rrugët lidhëse me fshatin.

Këshilltar E.Bregu: Të gjitha rugët lidhëse janë bërë me kryetarin e Bashkisë të asaj kohe që ju po thoni.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ja po të marr këtë rrugën lidhëse nga Korçë- Polenë drejt Dërsnikut që e investuam vjet.

Këshilltar E.Bregu: Gjatësia e rrugëve është më e madhe sesa më parë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk po e them unë, më është thënë se është hedhur një gisht asfalt se kështu duhej. Nëse ajo rrugë do ishte bërë e plotë dhe unë do duhej të bëja vetëm mirëmbajtjen, ato lekë dp i kisha për diçka tjetër.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit kryetar. E hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim

Vota PRO 19

Vota KUNDËR 7

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 19 pro, 7 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Taksirat do bëjmë edhe një mbledhje tjetër në fillim të javës sepse kanë afate këto tavane, unë e kuptoj që ju e keni dorën e stakuar në pozicionin poshtë por taksirat do ju thërresim edhe njëherë.

Këshilltare M.Qeleshi: ( Nuk ka audio, flet pa mikrofoni.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mirë është që stakimi ta keni me raste të caktuara, jo vazhdimisht.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: E diskutuam mjaft, kalojmë në pikën tjetër. Mbledhja do caktohet në fund të mbledhjes të sotme, ditën e hënë prapë mbledhje në këtu jemi sikur, të jemi Brenda afatit.

### **Pika 7 e rendit të ditës.**

**“ PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 2,615,046 LEKË PËR BLERJE KARBURANTI PËR EMERGJENCAT CIVILE.”**

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Fondi prej 2,615,046 që Bashkia do t'i kalojë Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike, është një fond i trashëguar për riparimin e rrugëve të dëmtuara në njësitë administrative, ju ftoj ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje?

Këshilltar A.Zheku: Në lidhje me vlerën kam disa pyetje si do përdoren, ku do përdoren?

Sepse në relacion thuhet përhapjen e rrugëve të dëmtuara në zonat e thella, sa rrugë janë, si janë?

Mungon një informacion i detajuar i situatës emergjente, sa emergjente është e para dhe dokumentacioni mbështetës dhe llogaritja e detajuar e fondit qoftë nga Bashkia dhe NSHP-ja dhe një raport teknik i Nshp-së. Në vazhdës të fjalës që tha kryetari investime i rrugëve rurale, a nuk do përfshihen edhe këto fshatra në këtë investim?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Tani t'i përmbahemi rendit të ditës, mos ndalemi tek prioritetet.

Këshilltar A.Zheku: Ju lutem më lini të mbaroj. Pyetja është ekzaktësisht për këtë dhe meqenëse kryetari e përmendi që sivjet do jetë ky prioritet dhe po e lidh a mos mbivendosemi dhe pse duhet ky investim i karburantit aktual, të dyja përputhen mirëmbajtja e rrugëve dhe shpenzimi i karburantit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje tjetër?

Këshilltar L.Petri: A është marrë ndonjë refleksion nga ana e ekzekutivit të Bashkisë për masat korigjuese në lidhje me shkeljet dhe abuzimet për karburantin të cilat i ka deklaruar edhe KLSH-ja?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje tjetër?

Një përgjigje kryetar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Karburanti i cili blihet për emergjencat ka një procedurë dhe dokumentacion të caktuar sesi përdoret. Do blihet kjo sasi bazuar tek parashikimet që ka bërë Ndërmarrja, nisur nga eksperiencia e viteve të kaluar por edhe nga problematikat e evidentuara në territory kryesisht pas shirave të këtij viti, të cilat kanë shkaktuar shumë probleme. Do blihet kjo sasi dhe do shoqërohet me një dokumentacion shoqërues për çdo sasi e përdorur, foto para dhe mbrapa të ndërhyrjes. Ky karburant do përdoret vetëm për ndërhyrje emergjente. Riparimi i rrugëve me çakull, nuk ka lidhje me pjesën e investimeve sepse nuk thashë që do asfaltojmë çdo rrugë të çdo fshati. Fondi është i dedikuar për emergjencat, emergjencat e momentit kemi sigurimin e karburantit. Në lidhje me konstatimin e KLSH-së çdo vërtetje apo çdo rekomandim i sygjerim në raport me përdorimin e karburantit tek NSHP-ja përfshirë edhe karburantin e emergjencave është mbajtur parasyh.

Këshilltar L.Petri: Për procedurë nuk mora përgjigje. Pyetja ime ishte kjo a keni bërë ndonjë refleksion si ekzekutiv në lidhje me abuzimet e bëra nga karburantet në të shkuarën lidhur me raportet e KLSH-së.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk kuptove përgjigjen tani apo ta them edhe njëherë?

Është analizuar raporti i KLSH-së me gjetjet e karburantit tek NSHP dhe çdo rekomandim i lënë tek ky raport është plotësuar në vazhdim. KLSH-ja për sa i takon karburantit ka lënë disa rekomandime se cilat procedura duhet të kishte dokumentacioni më tepër. Ka kërkuar pjesë e dokumentacionit të ketë më tepër detaje, urdhëra.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem t'i përmbahemi pikave të rendit të ditës sepse po filluam kështu zgjatemi, në pikat e ndryshme mund të trajtoni çfarë të doni por jo pika jashtë rendit të ditës. Është e dedikuar kjo pikë e rendit të ditës për karburantin për emergjencat civile.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pasi blihet karburanti dhe përdorimi pastaj rast pas rasti shoqërohet me dokumentacion sipas përcaktimeve të VKM-së për emergjencat, ka foto e thashë dy herë kjo është e treta.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Lazjoni e ka përcaktuar qartë se çfarë do jo si doni ju të jepni përgjigje. Lazjon fjala për ty.

Këshilltar L.Petri: Jam i qartë që një ndryshim procedural që keni bërë është shtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën si konsumohet karburanti për shërbimet publike. Një nga përfundimet e refleksionit që ju keni bërë keni konstatuar që kishte shkelje apo jo?

Tani mungonte dokumentacioni e kuptoj, por thjesht mungonte dokumentacioni apo kishte dhe shkelje?

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me blerjen e kësaj sasive karburanti për emergjencat civile kisha një pyetje. Jo do jetë e gjithë sasia dhe do mbahet e depozituar në magazine e Bashkisë, a ka Bashkia kapacitetet për të magazinuar karburantin?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo sasi si dhe gjithë sasi të tjera të karburantit që blihet jo për emergjencat civile, tërhiqet në trajtë tallonash naftë sipas nevojave që ka Bashkia dhe mbahen në magazine, mund ta shpjegojë Valbona që jemi të pajisur edhe me karta që mbahet sasia.

Shpjegoja Anxhela.

Drejtorja Juridike A.Qeramxhi.Dishnica: Çdo përdorues mjete ka një kartë e cila furnizohet në bazë të normativave mujore që duhet të harxhojë mjete, sasia e ngelur kalon për muajin tjetër.

Këshilltar I.Bode: Nuk ka pse të na vijë çudi me këtë skepticizëm që kemi ne si këshilltarë të opozitës sidomos me NSHP-në sepse ajo është e famshme për to, nëse ju kujtohet kanë harxhuar 3 milion për makinën e drejtorit para disa vitesh, kjo na jep të drejtën të jemi skeptikë znj.kryetare sepse dhe çmimet po rriten dhe mos na ndodhë që shoferat ta shesin fshehur.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Sa do doja të mendonit pozitivisht, nëse nuk ka diçka tjetër po hap procesin e votimit.

Hidhet në votim

Vota PRO 20

Vota KUNDËR 6

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 20 pro, 6 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk ka problem që nuk u miratua, do miratohet mbledhjen e ardhshme por duhet të keni parasysh dhe mos thoni pastaj pse do na i përdorëshse janë banorët që po presin t'ju çakullohen rrugët me këtë karburant do bëheshin nuk kemi tjetër. Do jem i detyruar t'ju them sepse do pyesin dhe do them këshilltarët e djathtë dhe Lazjoni si këshilltar i pavarur ngriti dorën mos marr karburant për emergjencat dhe për këtë arsye do prisni, Prandaj ju them ta vini dorën në punë dhe mos e mbani dorën e stakuar në pozicionin kundër sepse këto karriget që keni zënë këtu nuk janë vetëm për të bërë politikë. Do bëj një postim, ju e votuat dhe kjo mbaroi për këtë rradhë. Do bëj një postim dhe do them grupi i këshilltarëve të djathtë dhe Lazjoni sepse ai është pak i veçantë ngriti dorën që ju mos i keni këto shërbime.

Këshilltar E.Bregu: Banorët do thonë pse nuk more masat kur kishe shumicën.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Një këshilltar i përgjegjshëm ose Lazjoni mund të bënte diferencën nga bllokohen punët e emergjencave dhe nga fillojnë. Qesherake është qëndrimi juaj.

Këshilltar A.Zheku: Ne kërkuam dokumentacion justifikues, ne nuk thamë nuk e votojmë.

Këshilltare A.Zheku: 7 veta nuk bëjnë diferencën në 41 kryetar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E shikon si u shqetësuar.

Këshilltar E.Bregu: Si do ju përgjigjesh banorëve kur të pyesin pse i ke lënë në shtëpi këshilltarët tend?

A ke përgjigje?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Shoqja Alketa e kishe kërkuar sepse ishte dhe në komision.

Këshilltare A.Zheku: Ta dëgjojë edhe publiku.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mbaroi votimi ju lutem mos e zgjatim më.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Për procedurë mbaroi votimi nuk diskutohet më pika.

Këshilltar I.Bode: Ju lutem znj.kryetare.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Jo nuk ka nevojë fare kalojmë në pikën e 8.

Këshilltar I.Bode: Unë do e them edhe pse ju nuk doni.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ta kam ndërprerë fjalën jam në pikën e 7 të rendit të ditës.

Këshilltar I.Bode: ( Nuk ka audio.)

### **Pika 8 e rendit të ditës.**

**“ PËR MIRATIMIN E RIALOKIMIT TË FONDIT PREJ 801,777 LEKË PËR PUNIME MIRËMBAJTJE NË SPORTIN E VOGËL”.**

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem ekzekutivi një sqarim. Kryetar ju lutem një sqarim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pika e rradhës e cila u fut jashtërradhe në këtë mbledhje është alokimi i një fondi prej 800 mijë lek të reja për të realizuar financimin për një ndërhyrje për rikonstruksionin e sportit të vogël. Është një ndërhyrje e cila është investuar para shumë vitesh nga ana e Bashkisë por për shkak të terrenit sportive është dëmtuar nga kushtet e motit, duam të kryejmë një ndërhyrje tjetër të ndryshojmë tapetin e fushës dhe të përmirësojmë edhe një pjesë të infrastrukturës ekzistuese që në është dëmtuar nga akte vandal, dëmtimi i stolave dhe dhoma e veshjes, zhveshjes. Fillimisht kishim menduar ta financonim me buxhetin e Bashkisë 100% po na ka ngelur një fond nga Tapi e cila po përdoret për shtrimin e kalldrëmëve të rrugëve në Vithkuq. Do ulim numrin e financimit nga Bashkia dhe do përdorim këtë fond. Ju ftoj ta miratoni sepse është e rëndësishme edhe për infrastrukturën në pjesën qendrore të qytetit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltare A.Zheku: Shikoj destinacionin, nga fondi i parashikuar për përmirësimin e komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara, kalimi drejt destinacionit përkatës, nuk jemi absolutish kundër për investime në infrastrukturë, por për mua është më shumë e rëndësishme përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra të cilët e kanë të pamundur. Unë për vete e shoh më emergjente përmirësimin e banesave për komunitetet e varfëra ju duhet dhënë më shumë mbështetje atyre sesa jetës sportive, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ky fondi ka tepruar nga një fond prej 50 mijë euro mos gaboj që Tapi na ka dhënë për rikonstruksionin e tre rrugëve në Vithkuq. Ky fond teproi nga prokurimet dhe fillimisht ishte përdorur për përmirësimin e kushteve të banimit por ky project ishte më i madh në vlerë dhe atje kërkohet bashkëfinancime të tjera. Atje kishte disa prolematika të tjera që kërkonin më shumë kohë Tapi kërkoi të përdorej shpejt, menduam ta futnim tek ky projekt.

Këshilltar D.Osmani: Ky projekti që po ju hiqet fondi, përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra, mund ta dimë se cili është ky project, një informacion më shumë se kështu ja hoqëm këtyre, po ja u shtojmë këtyre, do shtrojmë këtë tapetin e sportit nuk më duket tama. Mund të kemi një informacion të detajuar për projektin që nuk po bëhet.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po e nis nga fundi edhe projekti i parë nga Bashkia është propozuar, projekti i parë ka qënë një ndërhyrje për rrjetin ujësjellsit tek ish godina e konviktit, pastaj kemi pare se ishte project më kompleks nuk përballohej kërkonte më shumë fond dhe duke qënë se Tapi kërkonte të përdorej sa më shpejt menduam këtë project. Projektin e parë do e shohim ta financojmë me fonde të tjera.

Këshilltar L.Petri: Mbaruam me pyetje znj.Kryetare, të bëj diskutime?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse mbaruan këshilltarët me pyetje po.

Këshilltar L.Petri: Unë jam i vetdijshëm që Bashkia ka nevojë për alokim fondesh dhe ky është njëri prej këtyre rasteve, unë dua të vë theksin në këtë pikë të rendit të ditës sepse duhet mirë mbajtje. Nuk është hera e parë që sporti i vogël është rikonstruktuar, sigurisht ka njerëz vandale por kjo nuk do të thotë që institucionet tona mos sigurojnë mirëmbajtjen dhe të mblidhemi sërish në një mbledhje x kohë nga sot dhe të na ftoni të miratojmë sërish rikonstruksionin e sportit të vogël. Janë shumë objekte të tjera e kam si sygjërim këtë, që kërkojnë fuqizim të mirëmbajtjes dhe masa për ata që i shkelin, ne jemi njësi e qeverisjes vendore dhe duhet të marrim masa për shkelësit pasi ka kamera dhe komunitet mos detyrohet të paguajë ekstra.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër po hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 5

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 21 pro, 0 kundër, 5 abstenim.

**Pika 9 e rendit të ditës.**

“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES NR.10216/1 PROT.DT.25.11.2022 NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A PËR ZGJEDHJEN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A SI AGJENT TATIMOR.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni i ligjeve ju lutem.

Këshilltare E.Mitre: Në bazë të marrëveshjes që cituat dhe ju është përcaktuar Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A si agjent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, familjare të Bashkisë Korçë. Si agjent tatimor është mbledhur deri tani taksa mbi ndërtesë, ndriçimi, pastrimi si dhe mirëmbajtja e varrezva, taksa buqësore. Propozohet të shtohet taksa mbi truallin e cila ka qënë që në vitin 2016 e miratuar por përfshirja në faturën e ujësjiellës, do lehtësonte qytetarët sepse e paguajnë atje, mund ta paguajnë me këste për muaj jo vjetore. Ju ftoj ta miratojmë këtë material.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje?

Këshilltar L.Petri: Znj. Kryetare kam 5 pyetje për këtë pikë.

Sa % e qytetarëve furnizohen me ujë të pijshëm nga ujësjiellës kanalizime Korçë?

E them këtë edhe për njësitë administrative, që ka Bashkia si është mbulesa?

Pyetja e dytë ku ka ceduar vjelja e taksës për truallin?

Pse propozohet fuqëzimi i ujësjiellës kanalizimeve si agjent tatimor?

Si është pritshëria nga ana e drejtorisë të taksave dhe tarifave vendore që kjo taksë e shtuar do e përmirësojë situatën buxhetore?

A do kalojë për konsultim publik?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Para se Soni t’ju përgjigjeve shifrave, nuk bëhet fjalë për taksë të shtuar që të kalojë për konsultim publik, se u bënë 3 vjet dhe duhet ta kishit kuptuar ndryshimin midis taksave dhe tarifave, taksat janë të përcaktuara në ligj, tarifat vendosen me vendim të Këshillit Bashkiak edhe niveli i tyre. Taksat janë të caktuara në ligj dhe mund të bësh diçka me vendim Këshilli + ose – 30 % mos gaboj, nuk kemi çfarë konsultim publik të bëjë. Duke qënë se si agjent tatimor kompania ka rezultuar shumë e sukseshme kemi menduar të futim dhe taksën e tokës. Kemi mundësinë që pagesën t’ja u shpërndajmë në 12 muaj, jo vjetore. Soni jep përgjigjen e pyetjeve të tjera.

Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Veendore S. Prifti: Në lidhje me pyejen sa % e qytetit furnizohet me ujë, në dijeninë time qyteti po e po por edhe një pjesë e njësisive, me përjashtim të disa fshatrave që nuk kanë pranuar të bashkohen me ujësellin. Taksa e truallit asnjëherë nuk ka qënë pjesë e faturës të ujit qytetarët kanë erdhur pranë sporteleve tona. Që taksat mos jenë të ndara menduam të përfshihet dhe kjo takes, nuk është takes e re është miratuar me vendim qeverie që në vitin 2016.

Nëse një familje per 100 m që ka në oborrin e saj paguan 42 lekë në vit takes e ndarë në kestë mujore 3.5 lekë, nuk ka asnjë kosot.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje apo diskutime?

Këshilltare M.Qelshi: Problemin e mbledhjes të të ardhurave e kemi diskutuar edhe në paketën fiskale dhe në komision. Me llogjikë është mekanizëm detyrues për qytetarët, nëse fatura e muajit është 100 lekë dhe nëse 50 lekë është shërbimi dhe 50 lekë taksa, nëse një qytetar nuk e paguan dot taksën në një moment shërbimin e ujit e merr, ama po nuk pagoi gjithë faturën i pritët. Kështu që ose të ishte gjetur një agjent tjetër tatimor që mos privohej qytetari nga detyrimi që ka për të paguar brenda faturës taksën dhe tarifën të ndërpritet nga shërbimi i ujit. Po e flas në parim dhe siç funksionin vërtet, një qytetar 5 muaj nuk paguan dot taksat dhe tarifën por shërbimin e ujit brenda tarifës mund ta paguajë. Një mekanizëm ose agjent tatimor tjetër, përshembull nëse do ketë hapësirën dhe qytetari që nëse i krijohet mundësia ta paguajë vetëm në verë, shërbimin e ujit është i detyruar ta marr por taksën dhe tarifën që është detyrues brenda faturës të muajit mos jetë i detyruar ta paguajë por të paguajë në një moment tjetër brenda vitit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ju e konstetoni këtë ujësjellësin si agjent tatimor, mund të na thoni një mënyrë tjetër?

Këshilltare M.Qelshi: 1342 punojës nuk na takon ne të japim mendim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ata janë 1983 në fakt, ju jeni zgjedhur me votë dhe nuk jeni zgjedhur ta mbani dorën stakuar negativisht.

Këshilltare M.Qelshi: E bërë refren këtë dorën stakuar sot, ajo vleen për të dyja palët, një pale e ka stakuar për po, një palë për jo.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ajo që bëtë me emergjencat njëherë ishte skandal, por po e marr me të qeshur nuk mund të votoni ndonjëherë pro?

Këshilltare M.Qelshi: Ne votjmë dhe pro dhe jo, po po flas për agjentin tatimor tani, gjej një mekanizëm mos i penalizosh.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ata prisnin fondin ju votuat kundër.

Këshilltare M.Qelshi: Unë jam në pike tjetër tani, të dhashë zgjidhje merrje kourumin dhe e bëje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E di sa fantastike je?

Këshilltare M.Qelshi: Jam shumë, 7 veta nuk bëjnë diferencën në 41. Jemi në ujësjellësi jo në emergjencat kryetar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më jepni një mendim konkret.

Këshilltare M. Qelshi: Nëse ma kërkon patjetër, nuk kam pse jap mendim tani pasi u diskutua. Kur të vijë momentin dhe të më pyesë zyrtarish do ju them.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po të pyes tani, ke ndonjë alternativë ju lutem?

Këshilltare M.Qeleshi: Nuk kam pse e jap tani, kam mendim por nuk e jap tani. Mos qesh sepse këto cinizma ju bëjnë qesharak, më falni po penalizohet qytetari nga shërbimi i ujit që e ka jetik, ti i kërkon të paguajë taksa dhe tarifa brenda kësaj fature.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Po z.Petri.

Këshilltar L.Petri: E falenderoj z.kryetare që në pikat pararendëse na zbardhi me transparencë sesi ka funksionuar shtrimi i rrugëve dhe kredia e marrë e lidh me këtë pikë sepse në finale është një perceptim për çdo banor të Bashkisë tonë një taksë dhe një tarifë që ne japim, ok taksat janë me ligj por kjo nuk do të thotë që nuk ka nevojë për konsultim kur ndryshohet metoda e vjeljes të saj dhe tarifat bëhen me vendim të Këshillit por të gjitha këto në perceptimin final janë ore si arkivohen dhe si përkthehen në një mirëqenie për ne, çfarë investime bëhen. Në lidhje me rrugët e qytet kam konstatuar se nuk kalon 1 muaj mos të prishen këpucët nga rrugët dhe makinat amortizohen.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem Lazjon mos kaloni në diskutime të tjera, në të ndryshme mund të diskutoni ç'të doni tani mos dilni nga pika ju lutem.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare të kërkoj ndjesë që nuk jam në pritshmëritë tuaja në lidhjen e pyetjeve por më lejoni ta mbaroj dikursin ju lutem.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Të lutem në lidhje me pyetjen a e more përgjigjen dhe a keni një mendim për vjeljen e taksës?

Këshilltar L.Petri: Nuk mora një përgjigje për % por mu tha se të gjithë kanë ujë të pijshëm gjë që nuk është e vërtetë ka fshatra të thella që ende nuk kanë ujë. Në lidhje me pyetjen pse ka ceduar mbledhja e taksës nuk mu dha përgjigje shteruese, për të tjerat mu dha.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Morët ndonjë përgjigje që ka ceduar?

Këshilltar L.Petri: Ndoshta për ju nuk ka ceduar, faleminderit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka dikush diçka tjetër?

Këshilltar P.Tollkuçi: Përshëndetje kolegë, mbledhja e taksës dhe tarifave nga fatura e ujit ka filluar prej kohësh ndoshta jemi dhe Bashkia e parë që e ka filluar, projekt në bashkëpunim dhe me Usaid mos gaboj. Ka funksionuar si praktikë dhe mendoj se ne nuk kemi pse shohim mëyrë tjetër dhe nuk ka mënyrë tjetër dhe ndarja e tarifës me këste lehtëson banorët, faleminderit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër hap procesin e votimit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër po hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 5

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 22 pro, 5 kundër, 0 abstenim.

## **Pika 10 e rendit të ditës.**

“ PËR MIRATIMIN E KËRKESËS TË SHOQËRISË ALBPOWER SHPK SI PËRFAQËSUESE E BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE ALBPOWER SHPK, FAVINA SHPK DHE FAVINA 1 SHPK “PËR DHËNIEN E TË DREJTËS TË NDËRTIMIT, OFRIMIT DHE MIRËMBAJTJEN E LINJËS NËNTOKËSORE TË TRANSFERIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË PRONAT E BASHKISË KORÇË”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ky material kaloi dhe për konsultim publik, një u zhvillua në njësinë Mollaj dhe një këtu në sallë ku jeni ftuar dhe ju të merrni pjesë. Komisioni ju lutem.

Këshilltari E.Mitre: Bashkimi i përkohshëm i këtyre shoqërive, kanë sjellë një kërkesë për kalimin e kabllove elektrike tek pronat e Bashkisë. Me VKM datë 21.01.2026, nr.21 është miratua kërkesa e subjektit për ndërtimin e centralit, kemi 8 pasuri nuk po i lexoj zonat kadastrale sepse i keni në material. Gjithashtu bashkimi i përkohshëm ka paraqitur edhe kërkesën e marrjes me qira dhe të drejtën e përdorimit të disa sipërfaqeve për vendosjen e shtyllave të energjisë elektrike. Kemi 15 pasuri sipas të cilat propozohen të vendosen në dispozicion të bashkimit të përkohshëm të shoqërive për ndërtimin e shtyllave. Sipërfaqe ku do vendosen shtyllat do jepen me kontratë qeraja 10 vjeçar.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Kur është paraqitur materiali për këshilltarët nga ana e investitorit është paraqitur kërkesa edhe për 8 prona të tjera ku 5 prej tyre bien në zk 85/64 dhe 3 të tjera janë në zonën 1958, në total vete deri në 1 km linja. Antenat janë nga 25 deri në 45 M2, pra propozojmë të shtohen edhe këto 8 prona, përveç atyre që ndodhen në material.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Do ju ftoja sa herë ka dëgjesa të jeni atje dhe të kuptoni më mirë.

Këshilltar E.Bregu: Nga materiali i paraqitur nuk ka shumë gjëra të sakta por mesa kuptova do vendosen disa antena, përveç linjave. Pyetja që kam është, këto antena a janë të dëmshme për shkak të rezatimit që lëshojnë?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Janë shtylla eolike, jo antena.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: ( Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar L.Petri: Dua të di për hrnimin e atyre rrugëve që do çënohen nga kalimi i kësaj linje nëntokësore 1 km kush do e paguajë?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Investitori, sepse nuk ishit në dëgjesat se ishte dhe investitori dhe banori.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo vetëm që e ka detyrim ta rikthejë në gjendjen e mëparshme por do i kërkohet nga ana jonë ato që janë me asfalt specifikimet në ndërrhyrje të jenë të tilla që mos krijojnë cedime në të ardhmen do e shohim tani, besoj duhet të jetë me tub metalik me beton sipër.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër po hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

### **Pika 11 e rendit të ditës.**

“PËR MIRATIMIN E SHKËMBIMIT TË PASURIVE NR. 4/1031, NR.4/168 ZK.8564 DHE NR.4/195, NR.4/1034 ZK 8564 MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SUBJEKTIT LARTI SHPK”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Dhe ky material kaloi për konsultim publik, pak këshilltarë ishin prezent.

Këshilltar E.Mitre: Nga ekzekutivi ka erdhur dhe ky material për shkëmbimin e pronave, Bashkia detyrohet t’i kalojë nëpërmjet kontratës të shkëmbimit Larti Shpk janë shesh në pronësi të Bashkisë Korçë, me sip totale 1697 m2 dhe truall + ndërtesë me sip totale 232.5 M2. Subjekti Larti Shpk do i kalojë Bashkisë truall + ndërtesë me sip totale 1767 m2 truall nga të cilat objekti i ish- Tecit 502m2 dhe truall 63.23 m2. Ky shkëmbim është interes në banorëve pasi ky objekt ka potencial të jashtë zakonshëm për zhvillimin kultërore dhe social, në material keni disa modele si janë shfrytëzuar kullat e ftohjes në vende të ndryshme, ju ftoj ta miratoni.

Këshilltar L..Petri: Kam disa pyetje. Kush u bë nismëtar për këtë marrëveshje?

I kujt isht interesi dhe motivimi dhe ku qëndron për këtë shkëmbim?

E lexova në material por e dua këtu shteruese.

Ku është relacioni që paraqet arsyetmimin e biznesit për këtë shkëmbim?

A ka raport nga drejoria rajonale e kulturës për vlerat kultërore që gëzon kjo kullë dhe një relacion edhe teknik që është në gjendje përdorimi dhe pse nuk u zgjodh e njëjta qasje me ish-Fabrikën e Qelqit, me ish- Trikotazhin?

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Ju i bëtë pyetjet dhe do merrni përgjigje nga drejtoira uridike, por ju në parim jeni ta marrim këtë objekt apo jo?

Këshilltar L.Petri: Të dëgjoj njëherë përgjigjet z.kryetar, pastaj do ju përgjigjem.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Kam përshtypje që po përpiqet të gjejë kush është qëndrimi jonë të kapë pozicionin kundër, duket tjetri që nga parashtesa, ato që janë prishur i dhembin, këto që i ruajmë thotë po mirë, çta duam.

Këshilltar L.Petri: Për procedurë. Z.Kryetar ju falenderoj për vëmendjen e tepërt që po më jepni por nuk keni të drejtë të paragjykoni sesi votojnë këshilltarët edhe më parë më përmendi dhe ma, le ta zbardhë dhe Eva si kam votuar për emergjencat, unë kam votuar pro, por është e drejta e tij të formulojë çfarë dëshiron sepse na thotë ne pastaj se bëjmë politikë. Megjithatë është e drejta e tij.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit për pyetjet. Ka pyetje tjetër, jo diskutime pyetje.

Këshilltar E.Bregu: Faleminderit znj.kryetare. Në lidhje me objektin që po diskutohet se është trashëgimi kultërore, doja të dija kjo ka qënë pronë shtetërore besoj por do e trajtojmë si trashëgimi kultërore.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Jo e tha Lazjoni atë gjë.

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me objektin e cila po vjen këtu në Këshill me propozim shkëmbimi me një pronar privat, kam përshtypje se kjo pronë ka qënë shtetërore.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Është private.

Këshilltar E.Bregu: Meqënëse Bashkia ka interes, pse nuk ka ndërhyrë më parë ta merrte këtë objekt?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Tani është dakortësuar me privatin.

Këshilltar E.Bregu: Si lindi ideja, kush është interesi?

Këshilltar M.Qelesi: Ka diçka edhe në lidhje me atë pjesën e Lazjonit, në rastin e shkëmbimit u kërkua nga Bashkia, u sqaruam në komision dhe në rast shkëmbimesh pronash duhet një interes i justifikuar publik. Në material kishim edhe probleme me llogaritjen e amortizimit, me anën teknike kishte material disa deficienca për minimin tim, jepeshin vetëm 5-6 arsye pse do përdorej kjo Kulla e Oxhakur, arsye të tjera nuk jepeshin. Përshembull mua nuk ma mbush mendjen ai observatori.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ato janë thjesht shëmbuj.

Këshilltar M.Qelesi: Ana të mbaroj unë, të lutem sepse ti na tërheq vëmendjen ne edhe ke të drejtë. Domethënë ku është interesi publik i justifikuar në rastin konkret, se interes publik është një rrugë, një shkollë, linjë prodhimi minimalisht që të shtohen dhe vendet e punës. Kurse ju keni venë në material vetëm 5-6 arsye pse përdoret Kulla, por kush është interesi dhe jo me këto esera.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mirela pa ndonjë qëllim të keq, thashë sepse kur u bë konsultimi publik atë ditë u hodhën idetë që përveç këtyre që janë përfshirë në material, mund të jepen edhe mendime prapë dhe të kalojnë për konsultime.

Këshilltar I.Bode: Ky shkëmbim bëhet në interes të asaj që janë këto prona të dy palëve të fregmentarizuara po grupohen secila në pronësi të dy palëve apo jo?

Për këtë qëllim po bëhet ky grupim?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka pyetje të tjera, kryetar fjala për ju.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Interesi ynë për interesin publik, është që këtë objekt ne ta ruajmë mos shkatërrohet, të ketë një përdorim i cili mund të jetë në realizimin e opsioneve të ndryshme, ato opsione që ne kemi venë në material janë disa opsione që i kam parë nga rivitalizimi në objekte të ndryshme të qyteteve të ndryshme. Ka shumë raste që Kulla e ngjashme janë ripërdorur nga

qytetet në një funksion publik dhe unë mendoj se kjo kullë e ka atë potencial. Që ta vemë në funksion publik duhet ta kemi në pronësi dhe pronësia ka qënë privat prej shumë vitesh, ne kemi qënë të interesuar që objektin ta marrim në pronësi dhe të zhvillojmë një ide konkrete se çfarë do jetë përdorimi. Pronari ka qënë i gatshëm ta kryejë këtë shkëmbim, pa dëmtuar veten e tij por duke na ndihmuar edhe ne ta kemi në pronësi.

Këshilltar L.Petri: Kulla duhet ruajtur për trashëgiminë që ka, këtu është shumë komplekse sepse ju na ftoni ta ruajmë këtë objekt por me këtë kusht, kushti është ky shkëmbim pronash dhe duhet bërë.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Ajo është pronësi private dhe mënyra si merr një pronë private është ose ta blesh, ose të shkëmbesh prona. Për ta blerë mund ta bëjmë por duhet të vemë komplet vlerën por ne kemi mundësi të shkëmbejmë.

Këshilltar L.Petri: E kam në këtë kontekst znj.kryetare, që keni qënë po ju që kur ka pasur zgjedhje për qeverisje vendore një nga premtimet që keni bërë ka qënë që do bëhet një park dhe sot shikojmë atje më shumë ndërtime sesa park.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Tani po thua diçka që.

Këshilltar L.Petri: Ju lutem z.Kryetar kam fjalën sepse e keni bërë si zakon që ndërprisni.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Mos ja fut kot se po i bën rradhë të futurat kot dhe nuk të skuqet faqja kur del keq kjo më shqhtëson.

Këshilltar L.Petri: Faleminderit për këshillën, më lejoni t'ja fut kot dhe znj.kryetare ju lutem respektoni rregulloren kur marrim fjalën ta kemi nga fillimi në fund.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Vazhdoni z.Petri.

Këshilltar L.Petri: Sigurisht kur është pronë private duhet gjetur një mekanizëm por të propozosh që do bëjmë një muze për trashëgimi industriale për mua është të hedhësh hi syve, sepse ne nga një anë i prishim këto objektet e trashëgimisë dhe ja po bëjmë muze t'ju tregojmë se çfarë kam bërë. Nga ana tjetër unë si banor dhe këshilltar i kësaj bashkie nuk mund ta pranoj nga kreytari përgjigjen që nuk e di kush e ka marr nismën, a thua se është në fshatin Lekas një pemë po shkëmbehet me një fidan dhe nuk e di, jemi në mes të qytetit po shkëmbehen dy pasuri që do ju ngelet brezave dhe na thuhet nuk e di.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Tani se u bë hera e shumta që nga ana juaj po deklarohen gjëra duke u vënë në gojën time dhe kur ju pyes kur ka ndodhur kjo gjë i bëni bisht dhe nuk ju lagen drutë. Tani po të pyes kur kam thënë se do bëhet park dhe tani i bëra bisht gjeje e ma thuaj. E dyta nuk kam thënë që atje do bëhet muze i trashëgimisë industriale, pikat e hedhur në material janë disa ide sesi infrastruktura të tilla janë rivitalizuar në qytete të ndryshme të botës. Janë të gjitha ide sot nuk asnjë ide përfundimtare se çfarë do bëhet. E treta nuk jam i sigurt se kush e mori formalisht kërkesën, interesi ynë ka qënë i hershëm për ta marrë atë objekt si Bashki. Tani nga ana formale le ta shohë Anxhela, kemi folur, kemi thënë e duam nuk duam të prishet. Tani ma gjej ku kam thënë që do bëhet park?

Këshilltar L.Petri: Z.Kryetar hapni arkivat e premtimeve për zgjedhjet ju lutem, unë e kam parë dhe me render kështu me fotoshop njëziti e shtrirë kështu si shezllon në park, por do e gjejmë. Si

kundër se mohojeni që keni thënë këtu se Parkun “ Rinia” do e dyfishojmë si sipëraqe dhe e kemi pamë që u dyfishua betoni.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Të zemë në gabim dhe nuk të lagen drutë fare, vazhdon me një përgjegjshmëri të admiureshe të hedhësh gënjeshtër dhe nuk e prisja nga ty këtë gjë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër po hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 25 pro, 1 kundër, 0 abstenim.

### **Pika 12 e rendit të ditës.**

**“ PËR DHËNIE TRUALLI PËR NDËRTIMIN E AMBULANCAVE NË FSHATRA  
POLENË, PULAHË, MALAVEC, GJONBABAS DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES TË  
BASHKËPUNIMIT SIPAS MATERIALIT BASHKËNGJITUR.”**

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare E.Mitre: Nga shoqata “ Gjysëm Hëna e Kuqe” është propozuar ndërtimi i 3 objekteve në fshatrat Polenë, Pulahë, Gjonbabas. Ndërtimi i objekteve do bëhet në pronat e Bashkisë dhe në përfundim do miratohet me leje ndërtimi që do i dhurohen Bashkisë, i keni të paraqitura në material zonat kadastrale nuk po i lexoj. Këto janë ambulanca që ne i kemi miratuara dhe më parë të tipit A2 dhe të furnizuara brenda me materialet e duhura për një ambulancë, ju ftoj ta miratoni.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka nga këshilltarët, po hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Po me emergjencat ç’patët?

### **Pika 13 e rendit të ditës.**

“PËR KALIMIN E PRONËSISË TË TRUALLIT PREJ 368 M2 TË DHËNË PËR NDËRTIM NGA ISH KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË RRETHIT KORÇË ME EMËR TË TRASHËGIMTARËVE LIGJORË TË TË NDJERIT Z. THEODHORAQ ELEZI”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare E.Mitre: Në bazë të dokumentacionit dhe në bazë të liigjit mbi kthimin e pronës, e keni të parashtruar në material gjithë dokumentacionin dhe nenet ligjore. Është bërë kërkesa nga z.Ilia Petro i cili ka prokurë që ka paraqitur kërkesën dhe kërkon të rikthehet pasuria në emrin e tij, ose trashëgimtarëve të z.Dhimitraq Elezi e llojit truall, me sip 368 M2. Nga specialistët është verifikuar gjendja e pasurisë dhe është hartuar plani i rilevimit për zonën kadasrale. Ju ftoj ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka nga këshilltarët e hedhim në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

**Pika 14 e rendit të ditës.**

“PËR NGJYRËN E AUTOMJETEVE TË SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKINË KORÇË”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare S.Dinellari: Komisioni nuk u mbledh, kështu që fjalën e ka ekzekutivi për shpjegim.

Këshilltare E.Mitre: Ne e kemi diskutuar pak tek komisioni i ligjeve dhe vetë taksistët kanë kërkuar që ngjyra e taksive të jetë gri me qëllim sepse dhe ata vetë shumica e tyre i kanë gri, por ato taksi të cilat janë në funksion dhe punojnë ende do e kenë ngjyrën jeshile me tavan të bardhë deri në momentin që ata do rinovojnë makinën e tyre do e heqin nga përdorimi dhe do e zvëndësojnë mendimin e tyre. Është kërkesë e taksistëve.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Kam kontaktuar me një përfaqësi e Shoqatës të Taksive të qyetetit dhe është bërë një kërkesë të ndryshohet ngjyra e caktuar e automjeteve të mëparshme me vendim Këshilli në ngjyrën gri, për shkak se pjesa më e madhe ka këtë ngjyrë. Ju kam kërkuar të sillnin një dakortësi të pjesës më të madhe të taksistëve, të takonin dhe kolegët e tyre dhe të na sillnin dakortësinë. Na e kanë sjellë, shumica ishin dakort dhe kemi gjykuar ta sjellim në Këshill. Për mos penalizuar ato pak taksi që kanë zbatuar Këshillin Bashkiak dhe ato do i lejojmë derisa të rinovojnë mjetet, për taksitë elektrike është lënë ngjyra që kanë.

Këshilltare A.Zheku: Për taksitë elektrike të tjera që do vijnë, do jenë të bardha apo gri?

Meqënëse u lanë të jenë të bardha këto që janë, nëse do ketë të tjera do jenë gri apo të bardha?

Këshilltari S.Dinellari: Duke vlerësuar faktin që ne po zbatojmë udhëzimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, por edhe vendimin e Këshillit që mjetet e tipit taksi të kenë një ngjyrë, thuhet në relacion më shumë se gjysma prej tyre. Ne kemi realisht të faktuar që gjysma e tyre e ka vërtet ngjyrën gri?

E dyta ata që do e lyejnë me ngjyrën gri çfarë kosto do kenë dhe a do mbështeten nga Bashkia?

Sepse ata që e kanë gri nu do paguajnë, gjysma tjetër që do i lyejë do paguajë dhe fakti që përjashtohen automjetet elektrike, kemi ndonjë argument pse përjashtohen, apo po presim të hyjnë në transport sepse mund të bëheshin dallime me ato që funksionojnë si kompani që ofronin transportin publik dhe jo ato që ofrohen nga Bashkia.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje tjetër?

Këshilltar L.Petri: Unë jam dakort të dallohen sepse janë më të pastra taksitë elektrike, ndërsa sa i takon atyre kontakteve që kisha nga komuniteti i taksistëve mësova që ata janë dakort që të ndodhë kjo gjë por kanë një shqetësim tjetër që është më i madh sesa kjo që po diksutojnë ne këtu e cila është kozmetikë në raport me këtë gjë, ndërkohë që ata thonë ne vuajmë nga një konkurrencë e padrejtë lidhur me tregun e zi të taksixhinjve dhe e dyta kërkojnë që ata shoferë që vijnë nga zonat e largëta në Korçë. Maliqi apo zona të tjera kërkesa e tyre është të kthehen bosh ose anasjelltas. Në se kanë kërkesën vajtje-ardhje atëherë po, kërkojnë një fokus më të madhe të institucioneve lidhur me këtë gjë, sepse po e vuajnë punësia ka rënë thonë dhe po ndodh ky fenomen vijnë nga Maliqi vijnë plot, bëjnë edhe shërbime brenda për brenda dhe më kupton. Doja ta ndaja me ju, faleminderit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kjo që ju thatë nuk ka lidhje me vendimmarrjen tonë, por fjala është për kryetarin.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Është e vërtetë që kjo nuk ka lidhje me vendimmarrjen por po e filloj nga pyetjet që lidhen me materialin. Ideja është që taksistë në bazë të ligjit duhet të kenë një ngjyrë të caktuar e cila miratohet në Këshill. Kjo deri më sot ka pasur një vendimmarrje që e cakton jeshile me të bardhë por pjesa më e madhe nuk e zbatojnë. Sot që flasim po kërkohet nga ana e Drejtorisë të Transportit duhet të kenë një ngjyrë, ndodhur në këto kushte kam folur me taksistë dhe më kanë propozuar që ngjyra të jetë gri për shkak se shumica e mjeteve ekzistuese janë gri dhe nuk do duhet t'i bëjnë dhe do identifikohen si taksi nga logoja. Taksistë që kanë respektuar vendimin e Këshillit do duhet ta mbajnë deri në rinovimin e mjetit, taksistë e tjera do duhet ta bëjnë, Nga kjo vendimarrje kuptojmë se ulet kostoja për shumicën e tyre, Kaq është maksimumi jonë, nuk legjitimohemi ne të mbulojmë kostot e ngjyimit të taksisë. Për mjetet elektrike po lemë ngjyrën aktuale, ngjyra e bardhë, nëse më vonë do ketë mjete elektrike me ngjyra të tjera do mblidhemi sërisht të diskutojmë.

Këshilltari A.Zheku: Nëse paraqet një kërkesë për tu linçesuar si taksi do duhet të presë mbledhjen e ardhshme të Këshillit të Bashkisë nëse e ka elektrike apo është më mirë ta vendosim sot? Nëse dikush nesër ka një makinë elektrike do vetëpunësohet si taksi taxi.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Çfarë propozoni ta lemë të bardhë?

Ok nëse nesër na vjen një grup taksish dhe na thotë kemi ngjyrë tjetër, do mblidhemi sërisht ta vendosim. Në lidhje me konkurrencën është e vërtetë, ne bashkë me Nikolinin jemi ulur me një grup taksistësh dhe i kemi drejtuar drejt autoriteteve përkatëse, lidhur me këtë duhet të merret

policia e qarkullimit rrugor dhe Drejtoria e Transportit edhe nga tatimet duke qënë se janë aktivitet i pa licensuar dhe nga Bashkia. Pra 4 institucionet ku gjithsecili duhet të bëjë punët e tij për ta minimizuar. Ne kemi zhvilluar shumë takime madje kemi çuar tek policia edhe targat kur na i kanë dhënë, diku kanë patur rezultat të plotë, diku të pjesshëm. Në lidhje me Bashkitë që vijnë jashtë Korçë duhet të kthehen bosh, kemi kërkuar edhe atyre të qarkullimit edhe me Policinë Bashkiake.

Drejtoria e Transportit N.Lika: Lidhur me kontollin që ushtrohet këtë e ka ndjekur në vazhdimësi Policia Bashkiake, janë gjobitur kur vijnë nga Bashkitë e tjera. Është problem i trajtuar jo i zgjidhur, kur konstatohen shkelje gjobiten dhe këtë e ka bërë Policia Bashkiake. Në lidhje me ngjyrën është e thjeshtë sepse kjo është e dallueshme nga leja e qarkullimit sepse dorëzohet në çdo rast kur merr lishencën dhe është e përcaktuar dhe ngjyra e taksive, gri. Saktësisht janë 50 me ngjyrë gri, 4 jeshile me të bardhë sipas vendimit të kaluar dhe 4 elektrike të bardha, pjesa tjetër me ngjyra të ndryshme, jo këtë ngjyrë.

Këshilltari S.Dinellari: Duke vlerësuar propozimet dhe fjalën e kryetarit, ne do respektojmë edhe udhëzimin e Ministrisë por gjukoj se ashtu siç vlerësoni gjysmën e automjeteve që kanë propozuar të ruhet ngjyra dhe unë nuk e shikoj si çështje estetike por e shikoj si kosto të familjes. E cila duke pasur parasysh që ata njerëz që punësohen në transportin publik do duhet ta marrin nga familja koston e ljerjes. Ndaj pyeta pak më parë, kryetar nëse do kenë ata a do kenë një mbështetje, sepse gjysma i ka kurse te tjerë do i lyejnë.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Ajo që mund të bëjmë ne si Këshill është të caktojmë një ngjyrë nuk legjitimohemi të mbulojmë kosto, ata që kemi në dorë hajde ta bëjmë sipas kërkesës të shumicës dhe ata që nuk e kanë gri ishin dakort.

Drejtoria e Transportit N.Lika: Ta përmbledhim, nëse do mbanim ngjyrën aktuale apo ndonjë ngjyrë tjetër të rrallë do detyroheshin të gjithë të bënin ngjyrë totale, gjë që nuk mund ta paguajë Bashkia, jo vetëm këtu por në asnjë vend. Kjo formulë që po themi gjysma do detyrohen ta lyejnë, gjysmat e kanë.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Mëshitetje financiare apo heqje nga taksa nuk bëhet fjalë. Tani ose do lemë një ngjyrë tjetër ose gri si të doni.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ata ranë dakort.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Nuk është se e kishim ne në plan, na erdhën para dy javësh na ngritën këtë shqetësim dhe bëmë këë material sepse që nga 2001 jemi 2026 nuk kishim sjellë ndonjëherë këtë material.

Këshilltar D.Osmani: Nuk ka audio, flet pa mikrofon.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Po propozojmë ta lemë ngjyrë gri dhe dallimin do e bëjnë dhe elementët e tjerë tabela dhe logoja. Nëse do kenë problem doe e diskutojmë sërish. Duke kuptuat vështirësite hajde i mbështesim me propozimin e erdhur prej tyre, nuk po e sjellim ne, ne po përcjellim zërin e tyre.

Këshilltar E.Bregu: Sa i përket ngjyrës, duhet të jetë ngjyrë të bëjë diferencën por meqënëse e kanë gri, mund të jetë dhe gri. Pjesa tjetër ka të bëjë me koston e atyre makinave që nuk janë gri dhe ata do duhet të bëjnë një investim dhe të kërkojnë ribursim apo nuk e di. Mendoj që ata duhet të shesin ato makina dhe të marrin të tjerë por kjo do kohë. Ndaj ne mund të marrim një

konsideratë t'ju lemë një afat kohor dhe do i shesin apo do i ndryshojnë është zgjedhja e tyre. Dujë ju lënë një afat kohor ne mendoj se i nddihmojmë për të reduktuar koston, këto që nuk janë gri të punojnë gri. Nëse marrim vendm ne, themi se Këshilli i ka lënë afat 6 muaj.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Nuk mund të marrim një vendim të tillë sepse bie ndesh me ligjin i cili thotë se taksitë dallohen nga ngjyra, tabela.

Këshilltar E.Bregu: Unë që e kam makinën me të verdhë them pse ta lyej gri. Une mendoj se pakica po kërkon rimbursim, nuk do kërkonin rimbursim nëse do ishin dakortësuar për lyerjen, të jemi pak korekt.

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Ky propozim na ka erdhur nga shoqata e tyre, ju si këshilltarë mund të thoni as jeshile, as gri do e lemë të kuqe, voton Këshilli do e lemë ashtu.

Këshilltar E.Bregu: Ti prropozon të votojmë mgjyrën gri?

Kryetar i Bashkisë S.Filo: Atë kanë sjellë këta ju mund të thoni jo e dua portokall ose blu.

Drejtorja e Transportit N.Lika: Detyrimi për të lyer mjetin është kur jepet akti i komoditetit, ai është dokumenti që jepet kushtet e plota të Bashkisë. Subjekte të ndryshë, afati i komoditetit mund të mbarojë në shtrirjen e një viti, njërit mund t'i mbarojë për 1 muaj ose mund të ketë një afat 1-vjeçar, kështu që çdo subjekti i lihet 1 afat për tu pajisur me aktin e ri dhe kjo nuk do të thotë absolutisht të gjithë të nxitojnë, ju jep shtrirje kohore sipas personit.

Këshilltar D.Osmeni: Ne nuk kemi në dorë kualidimin por kemi pjesën e afatit.

Drejtorja e Transportit N.Lika: Ai është dokument.

Këshilltar D.Osmeni: Mendova për të ndihmuar taksistin që e ka për 1 javë ose nesër.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Përderisa erdhën kaq shpejt janë dakortësuar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Lejën e komoditetit e marrin mjetet e transportit publik, fugornat, autobusta, taksi dhe lidhet me kushtet e brendshme, sedilie, taksimeter dhe ngjyra dhe e marrin tek Drejtorja e Transportit.

Këshilltar I.Bode: Ngjyrën e mjetit të detyruar e kërkon Drejtorja e Transportit dhe na kërkon ne të marrim vendim?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E kërkon ligji i cili deri më sot mesa po kuptojmë është neglizhuar në momentin e dhënies të çertifikatës të komodimit. Që të të jap çertifikatën duhet të plotësosh 1,2,3,4 dhe ngjyrën me vendim Këshili nëse nuk e ke nuk ta jap, kaq. Jeshile me të bardhe janë vetëm 4.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka nga këshilltarët e hedhim në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

**Pika 15 e rendit të ditës.**

“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS DHE ZGJEDHJES TË ANËTARIT TË KRYESISË TË FSHATIT LEKAS DHE ZGJEDHJES TË KRYETARIT TË FSHATIT LEKAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE LEKAS.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Është vazhdimi i procedurës si ajo e Vithkuqit, një shpjegim Eva.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Në mbledhjen e kalaur na ka erdhur një kërkesë nga njësia administrative Lekas e cila na është drejtuar ne si Këshill Bashkiak të shkarkojmë kryetarin e fshatit për arsye se nuk ushtron detyrën në momentet kur kërkohet nga banorët. Duke ju referuar kërkesë dhe diskutimit në mbledhjen e komisionit, duhet vendimi i Këshillit për vazhdimin e procedurave të shkarkimit dhe zgjedhjes të Kryetarit. Janë anëtarët e kryesisë ata që duhet të mblidhen të shkarkojnë dhe po ata me votim të fshehtë mes tyre jo më pak se dy kandidatura. Kjo do mbikëqyret nga një komision i cili është vendosur nga Këshilli kur u bënë zgjedhjet e kryesisë dhe kryetarëve të fshatrave, tek projektvendimi e kam caktuar secili është komisioni. Data do akordohet kur do mblidhet kryesia së bashku me njësinë administrative Lekas.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Anëtarë që do e mbikëqyrin janë Lorenc Nako, Ornela Alikaj, Kostika Zguri, Anxhela Taho, Suela Dinellari, Irvin Bode dhe Lazjon Ppetri.

Këshilltar I.Bode: Kërkesa për procedurën e shkarkimit ka erdhur nga njësia?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kryetari që kanë nuk e ushtron mirë detyrën.

Këshilltar I.Bode : E kuptova këtë, merakun im është përderisa zotëria është zgjedhur me votë.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Me votë zgjidhet kryesia e cila zgjedh kryetarin.

Këshilltar I.Bode : A nuk duhet të vinte nga kryesia kjo kërkesë?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nga kryesia ka erdhur.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Ta sqaroj unë, nga njësia ka erdhur ndaj ne propozojmë të mblidhet kryesia dhe të shkarkojë kryetarin nëse e shkarkon, në rast se e shkarkon përsëri kryesia zgjedh kryetarin. Duhet ta mbikëqyrin ne si Këshill procesin.

Këshilltar E.Bregu: Ky kryetari që do shkarkohet, është dëgjuar çfarë mendim ka apo jo?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Patjetër.

Këshilltar E.Bregu: Se mos po i bëni ndonjë puç atij.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Jo, nëse nuk ka diçka nga këshilltarët e hedhim në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 1

## Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 23 pro, 1 kundër, 1 abstenim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kalojmë tek raporti i vendimmarjes të Këshillit Bashkiak për vitin 2025, material të cilin Eva e ka shpërndarë. Nëse keni diçka tjetër mund ta shtoni.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Kemi bërë një sondazh lidhur me punët e Këshillit dhe draft raport të prezantuar nga faktoje.al kemi qënë një nga Këshillat Bashkiak të monitoruar dhe ishim një nga 4 Këshillat që ishim 100 % transparent për pjesën e punës.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem për qytetarët që kanë qënë qysh në fillim të mbledhjes t'ju japim fjalën.

Këshilltar D.Osmani: Dy fjalë e për ne se na takon meqënëse është raport performance Këshilli Tani në vlerësimin tim personal por edhe si kryetar grupi, në Këshill unë mendoj deri më sot pa çka mos dakortësisë për ndarësinë që kemi për menaxhimin e qytetit apo vendimmarjes. Unë mendoj se këto vite kanë qënë burim edhe i vlerësimit ndaj këtij Këshilli por edhe ndaj Bashkisë sepse dhe ne sot që jemi pjesë e opozitës në Këshill duam apo nuk duam ne, opinionin tonë gjithmonë e kemi dhënë për ecjen para të qytetit dhe në asnjë moment nuk kemi menduar të flasim politikisht dhe për këtë gjë nuk dua të paragjykohe mi. Ne jemi banorë, për politikë është Parlamenti dhe mendoj se këtë dashamirësi apo mirëkuptim do vazhdojmë ta kemi. Të vetmin problem që mendoj se e kemi problem është mbledhja e komisioneve e cila është shumë e domosdoshme të vlerësohet nga gjithsecili por mendoj se nuk jemi Këshilli i parë që kemi probleme, duhet parë pak pjesa se cila është arsyeja që këshilltarët nuk e shikojnë me përgjegjësi sepse vijmë këtu njëherë në muaj, marrim një pagesë që qytetarët e tjerë ¼ e marrin asistencë dhe jo për çështje financimi por për çështje vlerësimi ndaj votave, pa çka se jemi në listë partiake na kanë votuar të jemi këtu. Mbledhjet e komisionit duhen vlerësuar, ne jemi në jetën e përditshme në punë dhe nuk kemi kohë asnjë nga ne nuk e ka kohën e lirë por njëherë në muaj në mbledhjen e komisionit apo Këshillit duhet të jemi këtu dhe ta vlerësojmë të gjithë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Është përgjegjësi shumë e madhe e secilit prej nesh, jo vetëm që e kemi detyrim ligjor aq më tepër që ne e kemi të përcaktuar dhe me rregullore dhe secili atë ditë në muaj me përjashtim të mbledhjeve jashtërradhe që nuk kanë qënë të shpeshta. Por njëherë në muaj jo vetëm të jemi prezent por të jemi dhe një zë i atyre që kanë besuar dhe këtu le për të dëshiruar angazhimi për të folur nga këshilltarët për çdo çështje në rendin e ditës. Pjesa e efektivitetit unë bie dakort edhe me ju. Sa i përket komisioneve është shumë e rëndësishme prezenca, kjo jo vetëm ndihmon dhe rreh mendimet për specialistët e zgjedhur në atë komision por ndihmon edhe në mbarëvajtjen e punës të Këshillit sepse nuk ka sens për ato çështje që nuk dhe bëhet politikë të zvarritet atë pikë ku mund të sheshohet në komision, dilet në përfundim dhe për mua procesverbalet e komisioneve t'ju vihen në dispozicion para se të filloj mbledhja që dhe këshilltarët të jenë të informuar. Duke marrë mendim nga komisioni më jep mundësinë të diskutoj por edhe të mbaj një qëndrim, kështu që prezenca e komisioneve. Doja të falenderoja komisionin e finacave që është pothuajse gjithmonë prezent dhe ai i çështjeve sociale. Komisionet e tjera janë për tu erdhur keq. Mbase dhe vakanca që u krijua nga largmi i këshilltarit Nexhipi mbase do japë një spunto tjetër funksionimit të komisionit të ligjeve. Falenderoj Devin për mendimin do doja të ndaleshim tek qytetarë sepse kanë që në fillim. Ka erdhur një kërkesë nga znj. Vjollca. Para disa ditësh ju kam dërguar një ankesë për çështjen e

rrugës dhe informacion për procedurën e shpronësimit dhe nuk kam marrë përgjigje. Ky është shqetësim serioz për mua dhe pres një reagim nga ana juaj. Jam një person i sëmur dhe nuk mund të vij vazhdimisht tek zyrat tuaja, ju me keni parë dhe vetë që kam erdhur disa herë për këtë problem gjithashtu i kam shkrojtur drejtorit të urbanistikës Z.Ndriçim në whatsapp dhe nuk kam marrë përgjigje, ju jeni në atë detyrë për të dëgjuar dhe marrë në konsideratë ankesat dhe shqetësimet e qytetarëve. Nëse nuk marr përgjigje do e ngre këtë çështje zyrtarisht dhe me forcë në mbledhjet e Këshillit, pres përgjigje nga ju. Unë jam kam pëcjell ekzekutivitetit dhe pres një përgjigje prej tij. Sot në mëngjes kam folur edhe me drejtorin e urbanistikës, Anxhela ndoshta do e shpjegojë më mirë. Ata më thanë se duhet të verifikojmë nëse atje ka pronësi ku do hapet rruga apo jo.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Ne kemi aplikuar pranë ASHK-së për të marrë nëse projekti që kërkon zonja të realizohet a prek zona private dhe cila është zona kadastrale e tyre dhe në varësi të zërit kadastral del edhe vlera e shpronësimit. Duke pasur parasysh edhe atë fondin që kemi miratuar 3 million e 500 mijë për shpronësim, do shohim nëse mund të realizohet edhe ky shpronësim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka diçka nga qytetarët?

Qytetari: Ne kemi erdhur edhe njëherë për hapësirat e pronave dhe z.kryetar e di. Z.Kryetar dërgoi një shkresë në zyrën e rregjistrimit aplikoi për të parë edhe njëherë të vërtetën çfarë kishte. E mora zyrën e rregjistrimit është mëse e pastër dhe e qartë që saktëson numrin e pronës dhe metrot se sa ka ai qytetar. Ju lutem mos na vrisni fëmijët, unë kam kufij 2.5 m2 larg njëri-tjetrit dhe ai ka bllokuar komplet. Një topograf që vjen edhe mat edhe gënjen.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Prezantohuni edhe njëherë.

Qytetari: Kemi paguar kot vetëm nga një topograf që gënjen dhe mashtron. Ne nuk mund të vrasim djemtë, këta mbushin xhepat dhe ne të vrasim fëmijët. Nuk mund të verë hekur në pronën time.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk mund të vish këtu dhe të thuash topografi i Bashkisë mbush xhepat dhe ju po vriteni. Ne kemi folur dhe bashkë në zyrë dhe kam marrë shqetësimin tuaj dhe ju kam thënë do e verifikojmë në Hipotekë. Do marrim planimetrinë e kufitarit dhe planimetria e pronës e marrë nga hipoteka tregon që sipërfaqe që ju pretendoni se është ulicë është pronë e tjetrit. Fatime edhe njëherë mund të vish një vit rresht këtu por fakti që merr përgjigje që nuk të pëlqen nuk ke të drejtë, këtë përgjigje do marrësh sa herë të vish. Meqënëse keni ardhur Anxhela drejtoresha juridike ta mbajë topografin dhe t'ju sqarojë edhe njëherë për herë të pestë këtë gjë. Fakti që nuk ju pëlqen përgjigje nuk do të thotë se keni të drejtë. Kjo është përgjigjia e hipotekës. Do prisni të mbarojë mbledhja do takoni topografin do merrni sqarimin sipas rregullova.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Meqënëse mbaruan qytetarët, kalojmë në pika të ndryshme.

Këshilltar E.Bregu: U bë e disata herë që kërkojmë të njëjtën gjë. Meqënëse ne sot kemi pasur edhe një pikë bashkëpunimi me Ujësjellës Kanalizime Korçë dhe ne i jemi drejtuar kryetarit me shkresë disa herë për informacion për këtë shoqëri dhe ai ka thënë se nuk kam marrë ende përgjigje. Tani unë mendoj se Bashkia ka një bashkëpunim të ngushtë me këtë shoqëri ku ne jemi dhe aksionerë dhe vonesa në këto dokumentat e informacionit është e justifikueshme për mua, u bënë

gati dy vjet që presi, nuk presim më justifikime nga ana e kryetarit. E njëjta gjë ndodh edhe me Shoqërinë e Futbollit të “ Skënderbeut”, kemi bërë kërkesë e kemi firmosur nga disa këshilltarë dhe kryetari ende nuk ka kthyher përgjigje dhe përgjigja e fundit ka qënë i jemi drejtuar aksionerit mazhoritar dhe ende nuk ka kthyher përgjigje. Kjo është para disa muajsh, ndoshta po afron edhe viti që kryetari nuk na jep përgjigje. Nuk mund të vazhdojmë me këtë situatë sepse i bie që Bashkia nuk po e merr fare në konsideratë Këshillin. Tani fjala është për ju.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi. Disnica: ( Nuk ka audio, flet pa mikronon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kompania “ Ujësjellës Kanalizimeve” është shoqëri aksionere dhe Bashkia Korçë është aksioner minorancë, 51 % ka Ministria e Infrastrukturës. Ne kemi 20 e ca % jemi aksionere minorance por edhe mazhorancë po të ishim informacionin e jep shoqëria. Ka një ligj për transparencën, të drejtën e informimit referouni atij ligji në rast se e shkelim.

Këshilltar E.Bregu: Informacioni është kërkuar në periudhën kur ishit mazhorancë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe po të ishim mazhorancë nuk e japim ne informacionin e japin ata, ka edhe një ligj, ka edhe autoritet ku drejtohesh po u shkelën këto përcaktime ligjore, ka komisioner për transparencën. Ndiqni këto rrugët dhe merrni informacionin, për ne nuk ka problem.

Këshilltar E.Bregu: Ka një përgjigje tjetër në lidhje me Shoqërinë “ Skënderbeu”.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është përgjigja që ju kemi dhënë përgjigje, i jemi drejtuar Entitetit në fjalë për të marrë informacion nuk na ka dhënë përgjigje.

Këshilltar E.Bregu: Sipas ligjit pse nuk ankoheni më lart të merrni informacion?

Pse nuk ndiqni procedurat për të detyruar intetitetin, t’ju japë informacion?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Cilën procedurë?

Këshilltar E.Bregu: Atë që më treguat mua.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ajo është për transparencën, nuk ka lidhje me këtë.

Këshilltar E.Bregu: Atë ligj që më tregove mua, atë ndiq edhe ti.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ti kërkon informacion nga një institucion pa qënë pjesë e tij. Këtyre si aksionerë të presupozuar që jemi ja u kemi kërkuar informacionin.

Këshilltar E.Bregu: Tek të dyja jeni aksionerë edhe të Shoqëria “ Ujësjellës Kanalizime” edhe tek Ekipi i Futbollit “ Skënderbeut”, na sjell informacionin e kërkuar kemi dy vjet. Nëse nuk je në gjendje ta bësh këtë punë mos e mbaj karrigen kot, populli ta ka dhënë ta mbash drejt, ti nuk po e mban dot.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ky është njoftimi për mbledhjen. Ditën e hënë, mbledhja jashtë rradhe i bie e Këshillit Bashkiak për të miratuar tavanet, dy çështjet të cilat nuk u miratuan sepse kanë afate. Atëherë të hënë në orën 10 takohemi përsëri.